23.06.2017

90/4
23.06.2017

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit -Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta-Ministry of Culture, Youth &Sports*

**Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore / Regionalni Centar za Kulturno Nasledje / Bölge Kültürel Miras Merkezi / Regional Center for Cultural Heritage**
**Prizren**

| | |
|---|---|
| DATË/A: | 22.06.2017 |
| REFERENC-Ë: | Nr. 90/4 |
| PËR/ZA/TO: | Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor |
| CC: | |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | |
| NGA/OD/FROM: | Samir Hoxha - Drejtor i QRTK-së Prizren |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Vendimi i Komisionit të IKMM-së Prishtinë |

Po ju dërgojmë Vendimin e Komisionit të IKMM-së për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese-Konservuese të Trashëgimisë Kulturore nr.45/2017 të dt. 08.06.2017 për lëndën Sylë Çoçaj Nr.04-353/34849 për ndërtimin e objektit – shtëpi individuale për banim me lokal afarist në ngastrën kadastrale Nr. 02518-0

Lëndës ia bashkangjesim kopjen e Vendimit.

313 22.06.2017
PRISHTINË

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
***Qeveria – Vlada – Government***
**Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta / Ministry of Culture, Youth and Sports**

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve
Kosovo Institute for the Protection of Monuments
Institut Kosova za zaštitu spomenika

---

Nr. 45/2017
Datë: 08.06.2017

U.D. Drejtori i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve z. Agim Gërguri duke u mbështetur në nenin 3 (paragrafi, 4, 8), nenin 4 (paragrafët 14, 17, 19 dhe 20) nenin 6 (paragrafët 3, 4, 5, 7 dhe 8), nenin 12 (paragrafi 2) të Ligjit Nr. 02/L – 88 për Trashëgiminë Kulturore, si dhe në zbatim të vendimit Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit Nr. 18/2016 të datës 04.03.2016, mori këtë:

## VENDIM

1. Aprovohet rekomandimi i Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve: "Miratimi i Projektit për ndërtimin e objektit – shtëpi individuale për banim me lokal afarist në ngastrën kadastrale Nr. 02518 – 1 – 397 – 0 Z. K. Prizren".

2. Në bazë të rekomandimit të Komisionit, kërkohet që gjatë zbatimit, të respektohet projekti zbatues, i cili duhet të dorëzohet dhe miratohet në komision.

3. Zbatimi i punimeve sipas Projektit të aprovuar bëhet nën mbikëqyrjen e një eksperti nga Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore –Prizren.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Sylë Çoçaj nga Prizreni ka parashtruar kërkesë për ndërtimin e objektit-shtëpi individuale për banim me lokal afarist, etazhiteti B+P+1 me numër të parcelës 02518-1-397-0. Objekti që do të ndërtohet gjendet jashtë Zonës Historike të Prizrenit, sipas Planit të Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit. Ngastra kadastrale gjendet brenda Zonës Mbrotjëse (diku rreth 45 metra) të objektit të Beledijës së Vjetër që është në Listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme (10.10.2016 – 10.10.2017).

Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, pas shqyrtimit të lëndës, ka rekomanduar si më poshtë:

1. Aprovohet kërkesa e Sylë Çoçaj-t për ndërtimin e objektit – shtëpi individuale për banim me lokal afarist, etazhitet B+P+1, në ngastrën kadastrale 02518-1-397-0 në Prizren, brenda Zonës Mbrojtëse të monumentit të Beledijës së Vjetër.
2. Njoftohet pala se Projektin Kryesor, të Projektit Ideor të miratuar nga Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, duhet ta dorëzojë në QRTK-Prizren për verifikim (të gjitha kopjet e projektit që i nevojiten palës). Dy kopje dixhitale dhe dy kopje fizike të projektit kryesor mbeten në QRTK - Prizren (një për QRTK - në dhe një për IKMM-në).

Vendimi i dërgohet:

- *Kabinetit të Ministrit;*
- *Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave dhe Projekteve IKMM;*
- *Departamentit të Trashëgimisë Kulturore;*
- *QRTK – së përkatëse;*
- *Komunës përkatëse;*
- *Departamentit Ligjor – MKRS;*
- *Zyrës së Drejtorit të IKMM –së;*
- *Arkivit të IKMM –së;*
- *Arkivit të MKRS – së;*

Agim Gërguri
U.D. Drejtor